VENDIM
Nr. 71, datë 6.12.2016

AUTORIZIM I NDIHMËS SHTETËRORE NËPËRMJET PJESËMARRJES NË KAPITAL

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- Znj. Milva Ekonomi kryetare;
- Znj. Mimoza Dhëmbi anëtare;
- Z. Ahmet Mançellari anëtar;
- Z. Petrit Bakiu anëtar;
- Z. Gramoz Hoxha anëtar.

Në mbledhjen e tij të datës 6.12.2016, shqyrtoi masën e sipërpërmendur, të njoftuar nga Agjencia për Zhvillim Ekonomik Rajonal dhe vendosi të konsiderojë ndihmën në përputhje me legjislacionin për ndihmën shtetërore.

I. PROCEDURA

1. Me shkresën nr. 76, datë 2.12.2016, Agjencia për Zhvillim Ekonomik Rajonal (AZHER) njoftoi pranë Sektorit të Kontrollit të Ndihmës Shtetërore, në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS) masën e sipërpërmendur.

II. PËRSHKRIMI I MASËS

a) Objektivi i masës së ndihmës

2. Qëllimi i ndihmës është përmirësimi i ekonomisë në Shqipëri përmes financimit të pjesëmarrjes në shoqëri tregtare në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM).

b) Baza ligjore

3. Baza ligjore është vendimi i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 21, datë 18.4.2016, pika 3.

c) Dhënësi i ndihmës

4. Dhënës i ndihmës është Komiteti i Zhvillimit të Rajoneve, ndërsa zbatues i skemës është Agjencia për Zhvillim Ekonomik Rajonal (AZHER).

ç) Instrumenti i ndihmës

5. Ndihma do të jepet në formën e pjesëmarrjes në kapital.

d) Buxheti dhe kohëzgjatja e ndihmës

6. Vlera gjithsej e parashikuar për mbështetjen e ndërmarrjeve në formën e pjesëmarrjes në kapital është 50 000 000 lekë. Burimet financiare për financimin e ndërmarrjeve mund të jenë:

a) kontribut nga buxheti i shtetit;

b) të ardhurat e veta, nga mjete dhe/ose burime të tjera financiare, nëpërmjet:

i) kontributit nga programe të ndihmës së huaj, sipas marrëveshjeve me partnerët e huaj për zhvillim dhe integrim;

ii) kostove të menaxhimit, për programe apo projekte që ata zhvillojnë, me disa përfitues;

iii) burime të tjera të ligjshme, si donacione etj.

Masa do të zbatohet për periudhën 2016–2017.

e) Përfituesit e ndihmës

7. Masa ka për qëllim të shoqërojë investimet infrastrukturore, vendore dhe rajonale, me masa nxitëse ndaj aktiviteteve ekonomike brenda dhe rreth zonës ku do të investohet, sipas objektivave të politikës së zhvillimit rajonal; të nxitë krijimin e partneriteteve ndërvendore dhe rajonale me partnerë publikë dhe privatë; të financojë projektet zhvillimore, të cilat nxitin zhvillimin e ekonomisë rajonale dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

8. Ndihma në formën e pjesëmarrjes në shoqëri tregtare, ku parashikohen të jenë përfitues 1 deri

në 10 ndërmarrje të vogla dhe të mesme.

ë) Aktivitet të cilat përfitojnë ndihmën shtetërore

9. Një ndërmarrje e vogël dhe e mesme do të përfitojë ndihmë shtetërore nëse do të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- është ndërmarrje e klasifikuar si ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), sipas ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, "Për ndërmarrjet e vogla e të mesme", të ndryshuar;
- ka selinë ose vendin kryesor të prodhimit brenda territorit të rajonit;
- ka paguar të gjitha detyrimet e parashikuara nga legjislacioni doganor dhe tatimor;
- është në gjendje të financojë 50% të të gjitha kostove të projektit në fazën e aplikimit.

III. VLERËSIMI I NDIHMËS SHTETË-RORE

a) Ndihmë shtetërore e drejtpërdrejtë për ndërmarrjet

10. Neni 4, i ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, parashikon se: "Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarra nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore".

11. Masa e njoftuar mundëson përfitimin e burimeve financiare vetëm për një numër të caktuar ndërmarrjesh të vogla dhe të mesme me një aktivitet të caktuar ekonomik. Autoriteti publik (AZHER) do t'i ofrojë këtyre ndërmarrjeve burime financiare me kushte më të mira se sa ato që ofrohen në treg. Si rrjedhim, skema ofron një avantazh/përparësi gjatë procesit të përzgjedhjes së tyre. Produktet dhe shërbimet e ndërmarrjeve të përzgjedhura mund të jenë pjesë e tregut të përbashkët rajonal, duke përmirësuar pozitën konkurruese të tyre dhe më pas ndikuar në tregtinë rajonale.

12. Komisioni arrin në përfundimin se masa, në interpretimin që u bëhet akteve dhe fakteve të sipërpërmendura, është ndihmë shtetërore.

b) Përputhshmëria e skemës së ndihmës shtetërore

13. VKM-ja nr. 580, datë 3.8.2016, pika 4.3, parashikon se:

"Për skemën e financimit të pjesëmarrjes në shoqëri tregtare në varësi të vlerësimit për projektin e dorëzuar, aplikanti përfiton, nëpërmjet bashkëfinancimit, në formën e grantit të drejtpërdrejtë, deri në 50% të vlerës totale të investimit, por jo më shumë se 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë/projekti".

14. Sa më lart, skema e ndihmës ka efekt nxitës, duke qenë se është një burim i konsiderueshëm kapitali për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që në fazën e hershme të krijimit dhe fillimit të funksionimit të biznesit. Si e tillë, skema e njoftuar është në përputhje me nenin 13, shkronja "c" "Ndihma shtetërore që mund të lejohet", duke qenë se lehtëson zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike ose zhvillimin e zonave të caktuara ekonomike, deri në atë masë sa kjo ndihmë nuk është në kundërshtim me detyrimet e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 13, 17, shkronja "ç", 22, pika 2/1, 30 dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar:

VENDOSI:

1. Të autorizojë ndihmën shtetërore nëpërmjet pjesëmarrjes në kapital, të parashikuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 580, datë 3.8.2016, "Për krijimin e programit për mbështetjen

e ekonomisë dhe përcaktimin e përfituesve e të rregullave për zbatimin e tij", mbështetur në nenin 13, germa "c", të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, sepse lehtëson zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike ose zhvillimin e zonave të caktuara ekonomike, deri në atë masë sa kjo ndihmë nuk është në kundërshtim me detyrimet e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

2. Agjencia për Zhvillim Ekonomik Rajonal (AZHER), brenda datës 31 mars të çdo viti të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar, si edhe të japë çdo informacion që do të kërkohet për monitorimin dhe kontrollin e ndihmës së dhënë. Të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës të ruhen deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

3. Agjencia për Zhvillim Ekonomik Rajonal (AZHER), bazuar në nenin 20, pika 1, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", duhet të marrë miratimin paraprak të KNSH-së në rastin eventual të çdo ndryshimi të skemës së njoftuar.

4. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Milva Ekonomi